



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA KAVAJË

Nr. Prot.

Kavaje, me . . . 2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Datë: 02.10.2019**

**Për: B.O.E. "Enea" sh.p.k & "Leal" sh.p.k**

**Procedura e prokurimit: "Procedure e Hapur"**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF- 31185-07-23-2019**

Objekti i kontratës : **" Sherbim i pastrimit për njësitë administrative Luz i Vogel, Synej, Helmas"**

Fondi limit **71 356 707** (shtatedhjetë e një milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e shtate ) leke pa TVSH, per 3 (tre) vjet.

Afati kohor për ekzekutimin: **3 (tre) vite**, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët • oferta ekonomike më e favorshme

**Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. "B.O.E "Glavenica" sh.p.k & "Ed Konstruksion" sh.p.k**

"Glavenica" sh.p.k Nipt K17710805A

"Ed Konstruksion" sh.p.k Nipt K61625001I

Vlera: **52 067 400** (pesedhejte e dy milion e gjashtedhjetë e shtate mijë e katerqind) leke pa T.V.SH

**2. " SHPRESA" sh.p.k** Nipt K67917301H

Vlera: **60 711 125** (gjashtedhjetë milion e shtate qind e njëmbëdhjetë mijë e një qind e njëzet e pese) leke pa T.V.SH

**3. B.O.E: "Iridian" Sh.p.k & "Borshi" sh.p.k**

"Iridian" sh.p.k Nipt. K48130550S

"Borshi" sh.p.k Nipt. J66703103B

Vlera: **64 202 400** (*gjashtedhjetë e katër milion e dyqind e dy mijë e katërqind*) leke pa T.V.SH

4. **"REJ" sh.p.k** Nipt. J93711608Q

Vlera: **66 577 500** (*gjashtedhjetë e gjashtë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind*) leke pa T.V.SH

5. **B.O.E: "ENEA" sh.p.k & "LEAL" sh.p.k**

"ENEA" sh.p.k Nipt. K73220801B

"LEAL" sh.p.k Nipt. K64612402E

Vlera: **70 031 043** (*shtatëdhjetë milion e tridhjetë e një mijë e dyzet e tre*) leke pa T.V.SH

### **Operatorët Ekonomikë të s'kualifikuar :**

1. **"B.O.E "Glavenica" sh.p.k & "Ed Konstruksion" sh.p.k**

"Glavenica" sh.p.k me Nipt K17710805A

"Ed Konstruksion" sh.p.k me Nipt K61625001I

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Shoqëria Glavenica nuk ka të specifikuar në Ekstartin e QKB objektin "pastrim i sipërfaqeve urbane" që është dhe objekti i këtij prokurimi sipas kriterëve të përgjithshme të DST-se.
- Shoqëria Glavenica nuk ka kryer ndonjëherë punë shërbim pastrimi urban dhe nuk ka asnjë punë të ngjashme sipas preventivit dhe specifikimeve teknike
- Shoqëria ED Konstruksion ka punë të ngjashme si B.O.E , por mungon dokumentacioni i plote, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument i vlefshëm për të përcaktuar sasinë e punës për secilin operator në këtë B.O.E.
- Mjetet e shoqërisë Glavenica janë të vjetra dhe nuk plotësojnë kriterin e vitit të prodhimit të kërkuar në DST. Autoboti është kërkuar jo më poshtë se viti 2006 minimum ndërsa Glavenica e ka të vitit 1999.

2. **" SHPRESA" sh.p.k** me Nipt K67917301H

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Leja Mjedisore e tipit C, leshuar subjektit "**Shpresa" sh.p.k** është revokuar me Vendimin nr. 11 datë 18.04.2019 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Tiranë.

3. **"REJ" sh.p.k** me Nipt. J93711608Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Licenca III.1.A për shoqërinë REJ sh.p.k, nuk ka të përshkruar në objekt veprimtarinë "pastrim mbetjesh urbane" që është dhe objekti i prokurimit

- Nuk është paraqitur dhe librezë e punës për inxhinierin mekanik Tritan Mukollari.
- Shoqëria REJ sh.p.k ka detyrime të pashlyera ndaj Bashkisë Prrenjas nga Raporti i KLSH në shumën 1 743 237 leke, sipas vlerësimit të lëshuar nga Bashkia Prrenjas.
- Kontrata me Bashkinë Pogradec për punë të ngjashme është pa një numër protokoll (në këtë kontratë REJ sh.p.k ka qënë pjesë e një B.O.E). Mungon dokumentacioni i plotë pasi nuk është paraqitur asnjë dokument i vlefshëm për të përcaktuar sasinë e punës për secilin operator në këtë B.O.E.
- Në lidhje me mëtej është paraqitur një kontratë porositje me një shoqëri maqedonase për ekstraktin i paraqitur në këtë kontratë është i datës 15.01.2019 dhe nuk është e sigurtë nëse kjo shoqëri është akoma aktive.

#### 4. B.O.E: "Iridian" Sh.p.k & "Borshi" sh.p.k

"Iridian" sh.p.k me Nipt. K48130550S

"Borshi" sh.p.k me Nipt. J66703103B

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

- Shoqëria Iridian ka punë të ngjashme si B.O.E por mungon dokumentacioni i plotë për të përcaktuar sasinë e punës për secilin operator dhe nëse plotësohet apo jo kriteri 40 % punë të ngjashme.
- Nuk është paraqitur ekstrakti i QKB për shoqërinë BORSHI sh.p.k.
- Nuk është paraqitur vlerësim nga administrata tatimore për asnjërin nga shoqëritë e B.O.E
- Nuk është paraqitur vlerësim nga OSHEE ku të specifikohet qartësisht se titullari apo përdoruesi i kontratës që lëshohet vlerësimi nuk ka detyrime të energjisë elektrike.
- Në marrëveshjen e B.O.E nuk janë përcaktuar elementet konkrete të bashkëpunimit si punët dhe sasia specifike e punëve që do të kryejë secila nga shoqëritë përberëse të kësaj bashkimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë B.O.E "ENEA" sh.p.k & "LEAL" sh.p.k**

1. **"ENEA" sh.p.k** me Nipt. **K73220801B** me adresë: Tiranë Luz i vogël, Vorrozet, rruga Kavaje-Rrogzhi, ndërtesë 2 kateshe, kati 1, me zonë kadastrale nr 3817, nr pasurie 18/110, vol 17, fq 29

2. **"LEAL" sh.p.k** me Nipt. K64612402E me adresë: Fier Lushnje Lagjja 18 Tetori, Autostrada Rotondo e Savres-Rotondo e Plukut, km 3, vend depozitim mbetjesh me Nr. 784/1

se oferta e paraqitur prej tyre me një vlerë të përgjithshme prej **70 031 043** (shtatëdhjetë milion e tridhjetë e një mijë e dyzet e tre) leke pa T.V.SH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Kavaje, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të kësaj njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet

sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **20.09.2019**

**Ankesa:** Operatori Ekonomik "SILVER" sh.p.k, ka bere ankesë me shkresën nr.2501 Prot. date 30.07.2019 dhe i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 2501/2 dt. 05.08.2019.

**KRYETARI**  
**REDJAN KRALI**